



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K.

K R E U I

Dispozitat e Pergjithshme

N E N I 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K. eshte krijuar sipas kontrates dhe ketij statuti te perpiluar dhe nenshkruar nga ortaket:

1. Beyhan NAKIBOGLU, i biri i Osmanit, lindur në Gaziantep, Turqi më 25.07.1960, dhe banues në Tiranë në adresën Rr."Murat Toptani", "Gjergji Center", me shtetësi turke, me profesion biznesmen, me Nr. pasaporte TR-K 327285,

2. Osman Taner NAKIBOGLU, i biri i Nacit, lindur në Gaziantep, Turqi, më 10.08.1975, banues në Tiranë në adresën Rr."Murat Toptani", "Gjergji Center", me shtetësi turke, me profesion biznesmen, me Nr. pasaporte TR-H 965083

dhe,

3. Taulant KADIU, i biri i Menduhit, lindur në Lushnje, më 10.12.1976, banues në Tiranë në adresën Rr."Sami Frashëri", Pallati I ri pas Kinema Agimit, kati. 9, Nr. 23, me shtetësi shqiptare, me profesion inxhinier, me Nr. pasaporte 0066274.

N E N I 2

Emertimi i shoqerise eshte "UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K.

N E N I 3

Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj.

Taulant Kadriu Osman Taner Nakiboglu Beyhan Nakiboglu

N E N I 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K. ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

N E N I 5

Shoqeria ""UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K. eshte person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne organet perkatese.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj, kontraten dhe ne kete statut.

N E N I 6

Selia e shoqerise "UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K. eshte ne Tirane, Rr." Tre vellezerit e Kombit", (Rr. E Elbasanit), Tiranë.

N E N I 7

Administrator i shoqerise eshte z. Taulant KADIU.

N E N I 8

Shoqeria ka vulen e saj ne forme te rrumbullaket, me dimensione normale, brenda se ciles eshte shkruar: Shoqeria "UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K. Tirane. Albania.

N E N I 9

Shoqeria "UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K. eshte nje shoqeri tregtare qe ka per objekt dhe qellim kryesor:

- krijimin dhe menaxhimin e institucioneve arsimore parashkollore, fillore, 8-vjecare dhe te mesme,
- organizimin e kurseve te gjuhëve te huaja, te mesimit te kompjuterit, te kurseve shkencore dhe artistike,
- organizimin e shërbimit te internetit,
- dhënien e konsulencës lidhur me procedurat e nevojshme per vazhdimin e studimeve jashte shtetit,
- kryerjen e veprimeve per import-eksportin e mallrave industriale dhe te pajisjeve te ndryshme kancelerie,
- pergatitjen dhe botimin e librave dhe teksteve.

Taulant Kadiu



Osman T. Nakiboglu



Beyhan Nakiboglu



N E N I 10

Shoqeria ushtron veprimtarine e vet te percaktuar ne kete statut ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te cele dege, zyra dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda vendit dhe jashte tij ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku eshte hapur.

N E N I 11

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

N E N I 12

Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ortaket qe marrin pjese ne shoqeri nuk i nenshtrohen asaj si persona. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese. Po keshtu as shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te saj.

N E N I 13

Ortaket kane keto te drejta kryesore:

- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
- Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi qofte, ne perputhje me statutin dhe kontraten.
- Te marrin pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tyre ose vete.
- Te kerkojne t'iu jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
- Te bejne propozime dhe t'i paraqesin ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emerojne dhe te shkarkojne administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.
- Te heqin dore nga shoqeria duke u ofruar pjeset e tyre ortakeve te tjere dhe tua ofrojne ato te treteve vetem ne rast se asnje nga ortaket e tjere nuk do te ushtroje te drejten e kundershtimit. Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet ndaj ortakeve.

Toulan Kadriu Osman T. Nabboglu Beyhan Nakiboglu

N E N I 14

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Te depozitojnë kuotën e tyre në përputhje me aktin e themelimit të shoqërisë (kontraten) dhe me këtë statut.
- Te marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej tyre, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve që caktojnë ato.
- T'i japin shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Te kryejnë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

K R E U IIKUSHTET EKONOMIKEN E N I 15

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të veprimtarisë kontabel dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

N E N I 16

Për të bërë të mundur zhvillimin e shoqërisë caktohet një kapital themeltar prej 100 000 lekë. Ortakët marrin pjesë në formimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me kuotat e tyre në para si më poshtë:

1. Beyhan NAKIBOGLU me 20%, (njëzetë për qind)
2. Osman Taner NAKIBOGLU me 40%, (dyzetë për qind) dhe,
3. Taulant KADIU me 40%, (dyzetë për qind).

N E N I 17

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të saj ortakët kanë të drejtën e rritjes së tyre në mënyrë proporcionale.

N E N I 18

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkeshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Pjesët e kapitalit mund t'iu transferohen të tretëve vetëm me miratimin e ortakëve.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohet me akt noterial.

N E N I 19


Taulant Kadiu



Osman Taner Nakiboglu



Beyhan Nakiboglu



NOTA
TIRANE

Shoqëria në emer të vet është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmone në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që ajo kryen.

Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

N E N I 20

Shoqëria krijon fonde rezerve ose dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

Shoqëria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj mbulohen nga fondet rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare që kur dëshirojnë mund të derdhen prej ortakeve, në rastet kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

K R E U III

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

N E N I 21

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht viti i parë financiar fillon me ditën e regjistrimit të firmes dhe përfundon me 31.12.2001.


N E N I 22

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga ekspertët kontabel i autorizuar miratohen nga asambleja me shumicë absolute të ortakeve. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

N E N I 23

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamen tregtare etj, ndahen nëpërmjet ortakeve në përputhje me përqindjen e pjeseve të kapitalit themeltar që ka secila pale si dhe të punës së secilit ortak në veprimtarinë e shoqërisë.

Toulaent Kodica Osman Toner Nakiboglu Beyhan Nakiboglu



N E N I 24

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

K R E U IVADMINISTRIMIN E N I 25

Ortaket e shoqerise e perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

N E N I 26

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga cdo ortak, nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar ose nga likuiduesit.

N E N I 27

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asambleja e zakonshme vendos me shumice absolute te votave per ceshtje te tilla si: emerim ose shkarkim i administratorit, te ekspertit kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore, te ndarjes se fitimit.


Asambleja e jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si: ndryshimin e statutit, zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise para kohe.


Keto vendosen nga ortaket qe perfaqesojne 3\4 e pjeseve te kapitalit themeltar.


N E N I 28

Administrimi i shoqerise behet nga administratori. Ne shoqerine "UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K. si administrator caktohet z. Taulant KADIU, i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet me gjithë veprimtarine e saj.

N E N I 29

Taulant Kadiu


Osman Tena Nakuboglu


Beyhan Nakiboglu


Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e ortakeve. Emerimi i tij behet per nje kohezgjatje prej pesembedhete vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Ne marredhenie me ortaket administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky statut iu japin shprehimisht ortakeve. Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tyre gjate administrimit te shoqerise.

N E N I 30

Kompetencat e administratorit ne shoqeri jane:

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te beje propozimet e nevojshme ne asamblene e ortakeve kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijoje organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te propozoje ne asamblene e ortakeve per krijimin e njesive, srukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqese ate Asamblese se Ortakeve per miratim.
- Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit dhe te paraqese propozimet per miratim ne asamblene e ortakeve.
- Te siguroje zbatimin e perpikete te vendimeve te asamblese se ortakeve.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

N E N I 31

Kontrolli i shoqerise mund te kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje. Ata caktohen nga mbledhja e ortakeve. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se behet gabim ose behet e pamundur kryerja e detyres.

Toulaout Kadiu



K R E U V

Osman Tarek Nakiboglu



Beyhan Nakiboglu



KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISEN E N I 32

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet duke filluar nga viti 2001 si vit i pare i veprimtarise.

K R E U VIMARREDHENIET E PUNESN E N I 33

Marreveshja e punes ne shoqeri rregullon ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut.

N E N I 34

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marredhenies se punes.

Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

N E N I 35

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

N E N I 36

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

Toulaout Kadriu



Osman T. Nakiboglu



Beyhan Nakiboglu



K R E U VIIMBYLLJA E SHOQERISEN E N I 37

Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne aktin e themelimit (kontrate dhe statutin). Veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe sipas propozimit te bere nga nje prej ortakeve kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel ose kur te gjithë ortaket me perjashtim te njerit heqin dore nga shoqeria.

N E N I 38

Kur shoqeria likuidohet Asambleja e ortakeve mbledh komisionin e likuidimit i cili paraqet per miratim bilancin e likuidimit te shoqerise.

Shoqeria i jep fund veprimtarise ne castin e miratimit te bilancit te likuidimit.

N E N I 39

Mjetet financiare si dhe cdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise kur shoqeria likuidohet, ndahen nepermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e tyre ne kapitalin themeltar pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjithë kreditorët e shoqerise.

K R E U VIIIDISPOZITAT E FUNDITN E N I 40

Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahen ne seline e shoqerise.

N E N I 41

Ky statut eshte hartuar sot, me date.....2001 per shoqerine "UFUK, Education & Publication Company" SH.P.K Statuti hartohet ne gjuhen shqipe.

O R T A K E T

1. Beyhan NAKIBOGLU,

2. Osman Taner NAKIBOGLU

3. Taulant KADIU.